

**RAPORT**  
**MBI INSTRUMENTAT E FINANCIMIT TË PUSHTETIT VENDOR**

**2016 - 2018**



**Hanns Seidel Stiftung**



**Shoqata e Bashkive të Shqipërisë**

**Tiranë, 2019**

*Opinionet, gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura në këtë punim janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë e domosdoshmërisht ato të fondacionit Hanns-Seidel.*

*Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet në asnjë formë ose të përpunohet, shumfishohet dhe shpërndahet duke përdorur sistemet elektronike, pa lejen me shkrim të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë dhe fondacionit Hanns-Seidel, përveç rasteve kur një veprim i tillë është në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për të drejtat e autorit. Përdorimi komercial i këtij materiali nuk është i lejuar.*



## Tabela e Përmbajtjes

I.	Hyrje.....	3
II.	Kuadri Ligjor.....	4
II.I	Parimet themelore të financave të qeverisjes vendore.....	4
II.II	Burimet e të ardhurave të veta të qeverisjes vendore.....	4
II.III	Të ardhurat që rrjedhin nga burimet kombëtare.....	7
III.	Fondi për Zhvillimin e Rajoneve.....	10
III.I	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për vitin 2016.....	11
III.II	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për vitin 2017.....	13
III.III	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për vitin 2018.....	14
	Shpërndarja e Fondit sipas përkatësive politike.....	16
IV.	Shpërndarja e transfertës specifike.....	18
IV.1	Konviktet e arsimit parauniversitar.....	18
IV.2	Qëndrat e Shërbimeve Sociale.....	19
IV.3	Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH).....	20
IV.4	Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar.....	21
IV.5	Rrugët rurale.....	22
IV.6	Administrimi i pyjeve.....	23
IV.7	Ujitja dhe Kullimi.....	23



## I. Hyrje

Ky raport sjell një analizë të instrumentave të financimit të pushtetit vendor në kontekstin e decentralizimit fiskal, së bashku me kuadrin ligjor ku mbështeten këto instrumenta si dhe shpërndarjen e fondeve tek bashkitë.

Raporti përmban shifra faktike sesi janë shpërndarë grantet e pakushtëzuara, grantet e kushtëzuara, financimet për investime nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, si dhe financimet e funksioneve të reja e më konkretisht të institucioneve arsimore parauniversitare, shërbimeve sociale, mbrojtjes nga zjarri, ujitjes dhe kullimit, bujqësisë, mjedisit, menaxhimit të pyjeve dhe menaxhimit të rrugëve lokale.

Hartimi i këtij raporti bazohet në analizën e të dhënave nga burimet zyrtare të bashkive apo të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Periudha të cilën adreson ky raport është 2016 - 2018. Raporti ka për qëllim të evidentojë funksionimin e instrumentave të financimit të bashkive, koherencën e tyre, si dhe të vërejë mënyrën e shpërndarjes duke u bazuar në kriteret standarte por dhe në kriteret e përkatësisë politike.



## II. Kuadri Ligjor

Sigurimi i autonomisë financiare është një parim i garantuar nëpërmjet kushtetutës dhe dispozitave të tjera ligjore, duke përfshirë Ligjin 139/2015 për Vetqeverisjen Vendore, Ligjin për Buxhetin e Shtetit, Ligjin nr. 9632/2006 për Taksat Vendore, Ligjin nr. 9896/2008 për Huamarrjen Vendore dhe Ligjin e ri 68/2017 për Financat Vendore. Ky ligj i ri, i miratuar në prill 2017, tregon se decentralizimi fiskal mbetet një pjesë thelbësore e axhendës së reformave.

### II.I Parimet themelore të financave të qeverisjes vendore

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet burimeve financiare ligjore. Kuadri ligjor, duke nisur me Ligjin për Financat Vendore sanksionon parimet e mëposhtme sa i përket financimit të pushtetit vendor:

- Politikat kombëtare financiare garantojnë mjaftueshmërinë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe bazohen në parimin e shumëllojshmërisë së burimeve të të ardhurave.
- Funkcionet dhe kompetencat që u delegohen njësive të vetëqeverisjes vendore shoqërohen kurdoherë me mjetet e nevojshme financiare për realizimin e tyre.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifatat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërsëdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj.
- Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.
- Në rast se ndryshimet në politikën fiskale shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe bazës së taksave vendore apo të pjesës së të ardhurave të njësive të qeverisjes vendore nga taksat e ndara, Ministria e Financave është e detyruar të marrë masat për kompensimin e uljes, nëpërmjet rritjes së transfertave financiare dhe mundësive për huamarrjen vendore dhe/ose formave të tjera.
- Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa defiçit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore.

### II.II Burimet e të ardhurave të veta të qeverisjes vendore

Të ardhurat e veta të bashkive përbëhen nga taksat e ndara, taksat dhe tarifatat vendore dhe të ardhura të tjera nga veprimtaria e bashkive.

**Taksat e ndara** përfshijnë 97% të të ardhurave nga kalimi i të drejtës së pronësisë, 25% të të ardhurave nga tatimi i qarkullimit të automjeteve të përdorura, 5% të të ardhurave nga renta minerale dhe 2% të të ardhurave të të ardhurave personale.



## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

**Taksa mbi qarkullimin e automjeteve të përdorura** caktohet sipas formulës: Cilindrata në cm<sup>3</sup> x koeficienti fikse sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit. Taksa fikse për llojin e karburantit është 12.5 lekë për naftën dhe 10 lekë për benzinën. Mjetet me vjetërsi nga 0-3 vjet nuk janë subjekt i kësaj takse. Të ardhurat nga taksa dhe gjobat për çdo rast, mblihen nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Të ardhurat nga kjo taksë shpërndahen sipas procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, nga të cilat, 5% strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, 25% buxhetit të qeverisjes vendore dhe pjesa tjetër Buxhetit të Shtetit.

**Renta minerale** paguhet nga çdo person fizik ose juridik i licencuar që operon në industrinë minerare. Sipas një marrëdhënie kontraktuale me Ministrin përgjegjës për ekonominë, subjekti duhet të paguajë rentën minerare për burimet natyrore që nxjerr në territorin e Republikës së Shqipërisë. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i tatimpaguesit. 5 përqind e të ardhurave nga renta minerare i takon bashkisë ku zhvillohet veprimtaria. Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore. Në rastin kur aplikohet renta minerare në përqindje, kjo taksë llogaritet duke shumëzuar vlerën e produktit (pa TVSH) me përqindjen e rentës. Kur zbatohet renta bazuar në një çmim të caktuar, shuma e saj llogaritet duke shumëzuar sasi të shitjes së produktit me vlerën e rentës minerare.

**Tatimi mbi të ardhurat personale** llogaritet mbi të ardhurat e individëve. Individët rezidentë janë përgjegjës për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore për të gjitha burimet e të ardhurave. Individët jorezidentë i nënshtrohen detyrimit të tatimit mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore për burimet e të ardhurave të realizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë. Bazuar në Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes lokale", neni 25 pika 2, të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria Rajonale e Taksave për tatimin mbi të ardhurat personale do të ndahen me njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe 2% të të ardhurave nga kjo taksë kombëtare ajo kalon në bashki.

Të ardhurat nga **taksat vendore** përfshijnë të ardhurat nga taksa mbi pronën e paluajtshme, tatimi mbi biznesin e vogël dhe të tjera. Taksa mbi pronën është taksa më e rëndësishme vendore. Taksat e tjera lokale janë taksa mbi ndikimin në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, taksa e tabelës, taksa mbi donacionet, trashëgiminë dhe llotaritë lokale. Me përjashtim të rasteve kur në ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, bashkia, nëpërmjet këshillit bashkiak bën kategorizime më të hollësishme, në përputhje me kushtet dhe interesat vendore, brenda kategorive minimale të bazës së taksës, vendos për nivelin e taksës brenda kufijve të përcaktuar në ligj, dhe përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale.

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së **tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël**. Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to: të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 2 deri në 8



## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

milionë lekë, është 7.5 për qind. Bizneset me xhiro deri në 2 milionë lekë nuk paguajnë tatimfitimi, por një taksë të thjeshtuar. Administrata Tatimore Qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet.

Në **taksat mbi pasurinë e paluajtshme** përfshihen taksa mbi ndërtesat; taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin. Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë. Këshilli bashkiak vendos për nivelin e taksës, që do të zbatohet për çdo kategori minimale të bazës së taksës, në kufijtë plus-minus 30 për qind të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse.

Baza e **taksës së ndikimit në infrastrukturë** është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet. Klasifikimi si një investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit. Shkalla tatimore është shprehur si përqindje e vlerës së investimit dhe është 1 deri 3 për qind e kësaj vlere, me përjashtim të Bashkisë së Tiranës ku vlera është 2 deri 4 për qind e vlerës së investimit. Për ndërtesat që janë në proces të legalizimit, ndikimi në infrastrukturën e ndërtimeve të reja është 0.5 përqind e vlerës së investimit. Detyrimi për këtë taksë i përket investitorit.

**Taksa e tabelës** zbatohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private. Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve. Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit harton planin për vendosjen e mundshme të tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike.

Këshilli bashkiak kur e gjykon të domosdoshme, vendos **taksa me karakter të përkohshëm**, në interes të përgjithshëm të komunitetit, në territorin brenda juridiksionit të tij. Baza e llogaritjes së taksës së përkohshme për çdo tatimpagues është vlera e taksës së pasurisë së paluajtshme të tatimpaguesit në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Niveli i taksës së përkohshme nuk mund të jetë më i lartë se 35 për qind e bazës së taksës së pasurisë së paluajtshme të tatimpaguesit. Taksa e përkohshme nuk mund të zbatohet për më shumë se tre vjet nga hyrja në fuqi.

Bashkitë mund të mbledhin **tarifa** për shërbimet publike. Tarifë vendore është një pagesë që një individ, person fizik apo juridik bën në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur apo të drejte të dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Tarifat duhet të orientohen drejt mbulimit të kostos së shërbimeve të ofruara, konsumi i të cilave është i matshëm. Tarifat kryesore lidhen me zënien e hapësirës publike, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave, furnizimin me ujë dhe kanalizimet, ujitjen dhe kullimin, licencat dhe lejet dhe autorizimet.

Burime të tjera të ardhurash në bashki janë:

- të ardhurat nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë;



## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

---

- të ardhurat nga investimet mbi kapitalet;
- të ardhurat nga titujt dhe të drejtat e tjera të blera nga bashkia;
- të ardhurat nga fitimi i ndërmarrjeve publike në pronësi;
- të ardhurat nga partneritetet privat-publik.

Për vitin 2018, njësitë e vetëqeverisjes vendore në shkallë kombëtare kanë mbledhur vetë të ardhura fiskale nga taksat e tarifatat vendore në masën 24.2 miliard lekë, 3.9 miliard lekë më shumë ose gati 19 % më e lartë se në vitin 2017. Në vitin 2018, në krahasim me vitin 2015, të ardhurat e veta fiskale të qeverisjes vendore janë 11.1 miliard Lekë më shumë ose 85% më të larta<sup>1</sup>.

### II.III Të ardhurat që rrjedhin nga burimet kombëtare

Bashkitë krijojnë të ardhura nga këto burime kombëtare:

1. Transferta e pakushtëzuar;
2. Transfertat e kushtëzuara;
3. Transferta specifike;
4. Transfertat dhe ndihmat ndërkombëtare;
5. Huamarrja vendore
6. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve;

**Transferta e pakushtëzuar** nga qeverisja qendrore te njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin e funksioneve të veta, si dhe për arritjen e barazisë së shpërndarjes së burimeve financiare mes njësite të vetëqeverisjes vendore. Transferta e pakushtëzuar caktohet si përqindje fikse kundrejt të ardhurave të qëndrueshme publike, sipas përcaktimit në ligjin që rregullon financat vendore, si dhe shpërndahet sipas formulës së përcaktuar me ligj. Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga tatimet dhe taksat e ndara përdoren në autonomi të plotë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Transferta e pakushtëzuar ju siguron njësite vendore fonde për të ekzekutuar funksionet e tyre ekskluzive. Ky është burimi më i rëndësishëm i të ardhurave për njësitë vendore, dhe përbën më shumë se 50% të të ardhurave për rreth 43 nga 61 bashkitë e reja më të mëdha në fund të vitit 2016<sup>2</sup>. Ligji për Financat Vendore përcaktoi për herë të parë totalin e grantit duke sanksionuar dy kushte: transferta nuk duhet të jetë më pak se se 1% e Produktit të Brendshëm Bruto të parashikuar dhe jo më pak se shuma e alokuar vitin e kaluar, duke siguruar si parashikueshmërinë, stabilitetin dhe sigurinë e burimeve financiare me kalimin e kohës.

Ky ligj përfshin edhe formulën e re për ndarjen e granteve të pakushtëzua duke reflektuar implikimet e reformës territoriale dhe administrative dhe rritjen e barazisë, parashikueshmërisë dhe transparencës në ndarjen e burimeve. Kriteret e alokimit të formulës së re janë:

- a) 80% sipas popullsisë (bazuar në konceptin e qytetarëve rezidentë efektivë që janë të dhënat e Regjistrimit të vitit 2011 të përshtatura duke shtuar 30% të diferencës midis Regjistrimit Civil dhe Regjistrimit);

---

<sup>1</sup> *Financat Publike Vendore Raport I vjetor 2018 - Ministria e Financave dhe Ekonomisë*

<sup>2</sup> *NALAS Fiscal Decentralisation report, 2018*




## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

- b) 15% sipas dendësisë së popullsisë, me katër pragje densiteti të ndryshme, ku bashkitë me dendësi më të vogël përfitojnë nga burimet ekstra;
- c) 5% bazuar në numrin efektiv të nxënësve të arsimit fillor dhe të mesëm.

Ekualizimi fiskal kryhet brenda grantit të pakushtëzuar dhe bazohet në të hyrat e përbashkëta tatimore. Pasi të jetë llogaritur transferta e pakushtëzuar, atëherë kryhen modifikime për bashkitë ku të ardhurat totale për frymë nga taksat ekzistuese të përbashkëta janë nën 75% të mesatares kombëtare dhe 110% mbi mesataren kombëtare.

Në grafikun më poshtë paraqitet transferta e pakushtëzuar për vitet 2016, 2017 dhe 2018. Sic shihet, transferta ka pësuar një rritje prej 17.8% nga viti 2016 në vitin 2017. Rritja pasuese nga viti 2017 në 2018 është 7%. Transferta e pakushtëzuar në vitin 2018 ishte 14.8 miliard lekë.




**Transfertat e kushtëzuara** nga qeverisja qendrore do të bazohen në kriteret objektive dhe renditjen prioritarë të nevojave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, kushtet ekonomike, kërkesat e infrastrukturës, si dhe në strategjitë e zhvillimit në nivel kombëtar e rajonal. Transferta e kushtëzuar përdoret për qëllimin dhe në mënyrën e përcaktuar nga organi që jep transfertën.

Transferimet e kushtëzuara vijnë nga dy burime. E para është nga ndarjet nga ministritë e linjës që u janë ndarë njësive vendore për funksione të deleguara ose për funksione përgjegjësitë mbi të cilat praktikisht ndahen nga dy nivelet e qeverisjes. E dyta është nga një fond gjithnjë e më i madh i Zhvillimit Rajonal që ndan grantet e investimeve për bashkitë bazuar në konkurim. Në vitet e fundit, madhësia e transfertave të kushtëzuara nga Fondi për Zhvillim Rajonal është rritur ndjeshëm (shumë afër madhësisë së vetë grantit të pakushtëzuar), duke çuar në shqetësime se po grumbullon fondet që duhet të ishin ndarë për grantin e pakushtëzuar. Përdorimi i gjerë i transfertave të kushtëzuara ka zvogëluar ndjeshëm autonominë fiskale lokale të qeverive lokale dhe ka çuar në pretendime se ato janë duke u ndarë për qëllime politike, të cilat nuk pasqyrojnë qëllime të qarta zhvillimore lokale.





## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë



Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, si pjesa më e rëndësishme e transfertave të kushtëzuara është dyfishuar nga viti 2016 në 2017 (nga 3.2 miliardë lekë në 6.4 miliardë). Ndërsa nga viti 2017 në 2018. Fondi ka shënuar një rritje prej 2% duke mbetur pothuajse në nivelet e vitit paraardhës.


**Transferatat** specifike financojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për:

- a) financimin e funksioneve të reja të transferuara te njësitë e vetëqeverisjes vendore, për një periudhë tranzitore deri në përcaktimin e një skeme ekuivalente dhe të qëndrueshme financimi;
- b) financimin e shërbimeve në raste të emergjencave apo situatave të ngjashme me interes kombëtar, ku kërkohet bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë autonomi të plotë për të vendosur për shpenzimet brenda funksionit, sipas transfertës specifike të përcaktuar. Transferata specifike vjetore, për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore është, të paktën, sa mesatarja vjetore e shpenzimeve totale që qeverisja qendrore ka kryer për të njëjtin funksion në tre vitet e fundit para transferimit të funksionit në secilën nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të prekura. Nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore në fund të vitit buxhetor rezulton me fonde të papërdorura nga transfertat specifike për funksionin për të cilin janë dhënë këto fonde, ato trashëgohen për të njëjtin funksion në vitin pasardhës buxhetor.



## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë



Transfertat specifike kanë pasur një rritje më uniforme përgjatë 2016-2018. Konkretisht, rritja në 2017 ishte 13% krahasuar me 2016, ndërsa në 2018 rritja vjetore ishte 15%. Transfertat specifike për vitin 2018 kapën vlerën e 8.5 miliard lekëve.

Njësia e vetëqeverisjes vendore mund të marrë **transferta monetare dhe/ose ndihma nga një qeveri e huaj ose organizatë ndërkombëtare** sipas marrëveshjes së veçantë të nënshkruar ndërmjet tyre. Kushtet bazë të një marrëveshjeje të tillë i raportohen Ministrisë së Financave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, jo më vonë se 10 ditë nga data e nënshkrimit të marrëveshjes. Për organizimin e aktiviteteve të ndryshme ndërkombëtare, për raste emergjencash civile ose raste fatkeqësish natyrore, njësia e vetëqeverisjes vendore mund të japë transferta monetare dhe/ose ndihma për njësitë vendore të shteteve të tjera. Këto transferta dhe/ose ndihma miratohen me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të marrin **hua afatshkurtër dhe hua afatgjatë**, në përputhje me përcaktimet në ligjet që rregullojnë vetëqeverisjen vendore, huamarrjen vendore dhe menaxhimin e sistemit buxhetor. Ministria e Financave mund të kërkojë auditimin e jashtëm, të pavarur, për llogaritë e njësisë së vetëqeverisjes vendore para miratimit të huas afatgjatë vendore. Praktikisht, ky është një instrument i pashfrytëzueshëm nga bashkitë për shkak të procedurave të komplikuar administrative dhe kushteve të monitorimit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

### III. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një instrument zhvillimor dhe një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor, për të siguruar zbatimin e objektivave të politikës së kohezionit territorial, për të patur rajone me zhvillim të balancuar, konkurruese dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor.

Shpërndarja e financimit dhe menaxhimi i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve kryhet nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, i cili kryesohet nga Kryeministri dhe ka këtë përbërje:



## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

1.	Kryeministrin	Kryetar
2.	Zëvendëskryeministrin	Zëvendëskryetar;
3.	Ministrin e Financave dhe Ekonomisë	anëtar;
4.	Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	anëtar;
5.	Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	anëtar;
6.	Ministrin e Kulturës	anëtar;
7.	Ministrin e Brendshëm	anëtar;
8.	Kryetarin e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
9.	Kryetarin e Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;
10.	Kryetarin e Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar.

Përbërja e Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve ka ndryshuar në vitin 2018, duke reduktuar numrin e anëtareve nga 21 në 10. Ky reduktim shpjegohet me ndryshimet e organizuara në ministri të ndryshme dhe shpërbërja e agjensive të zhvillimit rajonal.

Skema konkurruese e granteve u prezantua në vitin 2006 si një mekanizëm për të rritur performancën dhe objektivitetin në financimin e investimeve të njësive vendore. Në vitin 2010, kjo skemë u zëvendësua nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve i cili funksionon si instrument i barazimit vertikal për të menaxhuar grantet e kushtëzuara.

Fondi gjithnjë e më i madh i Zhvillimit Rajonal ndan grantet e investimeve për bashkitë në baza konkurruese. Në të vërtetë, vitet e fundit, madhësia e Fondit për Zhvillim Rajonal është rritur ndjeshëm (shumë afër madhësisë së vetë grantit të pakushtëzuar), duke çuar në shqetësimin se po grumbullon fondet që duhet të ishin ndarë për grantin e pakushtëzuar. Përdorimi i gjerë i tij ka zvogëluar ndjeshëm autonominë fiskale lokale të bashkive dhe ka çuar në pretendime se ato janë ndarë për qëllime politike, të cilat nuk pasqyrojnë qëllime të qarta zhvillimore lokale.

Kësaj i shtohet dhe shqetësimi se fondet e FZHR mund të përdoren në mënyrë më efektive dhe efektive nga vetë bashkitë që kanë njohuri më të mira të nevojave reale dhe prioriteteve të zonave të tyre. Në fakt, grantet konkurruese – para FZHR së tanishme – u krijuan në mes të viteve 2000, dhe përbënin vetëm një pjesë të vogël të grantit të pakushtëzuar. Nga kjo perspektivë, Shoqata e Bashkive avokon për shfuqizimin e këtij Fondi dhe shpërndarjen e financimeve për bashkitë si pjesë e grantit të pakushtëzuar.

### III.I Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për vitin 2016

Për vitin 2016, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhej nga 3 shtylla: infrastruktura vendore, zhvillimi ekonomik dhe Shqipëria dixhitale. Shtylla I e programit të Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale Vendore përbëhej nga 6 grante konkurruese, specifikuar si më poshtë vijojnë:

- 1) për infrastrukturën vendore dhe rajonale;
- 2) për arsimin: arsimin bazë; për arsimin e mesëm dhe për arsimin universitar;
- 3) për sportin.
- 4) për shëndetësinë (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor);
- 5) për artin dhe kulturën;



## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë


- 6) për ujësjellës-kanalizime;
- 7) për rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim.

Shtylla II për Programin e Mbështetjes për Ekonominë përbëhet nga një grant konkurrues për mbështetjen financiare për zhvillim ekonomik dhe nën-programin e zhvillimit rajonal dhe lokal përmes mbështetjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Shtylla III ishte ajo e programit “Shqipëria dixhitale” me një grant konkurrues për “Shqipërinë dixhitale”.

Përgjatë vitit 2016, nga Fondi i Zhvillimit të rajoneve kanë përfituar 27 bashki, nga 61 në total. Bashkia që ka përfituar më shumë është bashkia Korçë me 15% të të gjithë fondit pasuar nga bashkitë Fier (11%), Divjakë (10%), Himarë (6%) dhe Sarandë (5%).


Shpërndarja e Fondit për vitin 2016 paraqitet në grafikun e mëposhtëm. Gati gjysma e shumës ka shkuar për financimin e projekteve në pesë bashkitë e sipërpërmendura, ndërsa 21 bashki të tjera ndajnë mes tyre gjysmën tjetër të Fondit.



Përsa i përket numrit të projekteve të financuara nga FZhR për vitin 2016, ai është 57 projekte. Këto projekte janë në zbatim nga 27 bashki. Bashkia me numrin më të madh të projekteve për vitin 2016 është bashkia Korçë me 7 të tilla, pasuar nga Himara dhe Divjaka me nga 4 projekte. Lushnjë, Librazhd, Fier dhe Elbasan kanë nga 3 projekte secila për këtë vit kalendarik. Nga 57 projekte në total, 16 ju përkasin bashkive të opozitës, ndërsa 41 bashkive të mazhorancës.



## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë



### III.II Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për vitin 2017

Për vitin 2017, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga 3 shtylla: infrastruktura vendore, zhvillimi ekonomik dhe Shqipëria dixhitale. Shtylla I e programit të Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale Vendore përbëhet nga 6 grante konkurruese, specifikuar si më poshtë vijojnë:

- 1) për infrastrukturën vendore dhe rajonale;
- 2) për arsimin: arsimin bazë; për arsimin e mesëm dhe për arsimin universitar;
- 3) për sportin.
- 4) për shëndetësinë (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor);
- 5) për artin dhe kulturën;
- 6) për ujësjellës-kanalizime;
- 7) për rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim.

Shtylla II për vitin 2017 ishte ajo e programit “Shqipëria dixhitale” me një grant konkurrues për “Shqipërinë dixhitale”. Shtylla III për Programin e Mbështetjes për Ekonominë përbëhet nga një grant konkurrues për mbështetjen financiare për zhvillim ekonomik.


Për vitin 2017, Fondi i Zhvillimit të Rajoneve është ndarë në financimin e projekteve të 48 bashkive, duke shënuar një rritje në krahasim më 2016 për numrin e bashkive përfituese. Lista kryesohet nga bashkia Tiranë (14.5%), më pas dy bashki që kanë qenë përfituese dhe në 2016 Korca (12.6%) dhe Fieri (9.6%) e më pas vijnë Durrësi (7.6%) dhe Elbasani (5.2%).

Dhe përgjatë 2017 vijon trendi i financimit të pak bashkive me shuma të konsiderueshme të fondeve. Më shumë se gjysma e fondit (52%) është shpërndarë në 4 bashkitë e para. Duke qenë se numri i bashkive përfituese është relativisht i lartë dhe për faktin se shumica ka përfituar fonde shumë të vogla, në grafikun e mëposhtëm po paraqesim ndarjen e fondeve për 15 bashki.




## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

### Shpërndarja e FZHR për 2017



Përsa i përket numrit të projekteve të financuara nga FZHR për vitin 2017, ai është 91 projekte. Këto projekte janë në zbatim nga 48 bashki. Bashkia me numrin më të madh të projekteve për vitin 2017 janë bashkitë Tiranë dhe Fier me 7 projekte të financuara, pasuar nga Korca me 4 projekte dhe Elbasani me 5. Patosi dhe Durrësi kanë nga 4 projekte secila për këtë vit kalendarik. Nga 91 projekte në total, 21 ju përkasin bashkive të opozitës, ndërsa 70 bashkive të mazhorancës.

### Numri i Projekteve - 2017



### III.III Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për vitin 2018

Për vitin 2018, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga 6 grante konkurruese, specifikuar, si më poshtë vijon:


- Granti për infrastrukturën vendore dhe rajonale;
- Grantet për arsimin;
- Granti për shëndetësinë (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor);
- Granti për artin dhe kulturën;
- Granti për ujësjellës-kanalizimet;




## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

- Granti për rehabilitimin mjedisor, gjelbërimin dhe pyllëzimin.

Përgjatë vitit 2018, nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve kanë përfituar 55 bashki. Pavarësisht numrit të madh përfitues, duhet të theksojmë se shumata përkatëse për 50 prej tyre janë poshtë nivelit 3% të totalit të Fondit. Bashkitë që kanë përfituar më shumë gjatë vitit 2018 janë Tirana (18.1%), Korça (7.4%),



Përsa i përket numrit të projekteve të financuara nga FZhR për vitin 2018, ai është 138 projekte. Këto projekte janë në zbatim nga 55 bashki. Bashkia me numrin më të madh të projekteve për vitin 2018 janë bashkitë Tirana me 15 projekte dhe Korça me 11 projekte të financuara, pasuar nga Fieri dhe Vlora me nga 7 projekte. Berati dhe Maliqi kanë nga 5 projekte secila për këtë vit kalendarik. Nga 138 projekte në total, 34 ju përkasin bashkive të opozitës, ndërsa 104 bashkive të mazhorancës.



Për vitin 2019, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet vetëm nga granti konkurrues për arsimin.




## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

### Shpërndarja e Fondit sipas përkatësive politike

Nga 27 bashki të udhëhequra nga opozita përgjatë mandatit 2015-2019, duhet të theksojmë faktin se bashkia Kamëz është e vetmja bashki e cila nuk ka përfituar asnjë financim nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve përgjatë viteve 2016-2018. Bashkia Skrapar po ashtu është e vetmja bashki të cilës i është miratuar vetëm një projekt përgjatë tre viteve. Bashkitë e tjera kanë përfituar fonde në dy vite secila. Në total bashkitë e djathta kanë menaxhuar afërsisht 20% të Fondit e shpërndarë gati në mënyrë të barabartë në të tre vitet. Më poshtë paraqitet në grafik përqindjet përkatëse.

Bashkitë që kanë përfituar më shumë fonde janë bashkitë Berat, Kavajë dhe Gjirokastër me përkatësisht 2.3%, 3% dhe 2.3% të totalit të fondit të tre viteve bashkë.




34 bashkitë e tjera të drejtuara nga mazhoranca menaxhuan pjesën tjetër të Fondit prej 80 % të shpërndarë në mënyrë gati të barabartë përgjatë tre viteve. Grafiku i mëposhtëm tregon përqindjet përkarëse të menaxhuara nga këto bashki në vitet 2016, 2017 dhe 2018. Duhet bërë përjashtimi për bashkinë e Pustecit e cila nuk ka përfituar asnjë financim nga ky mekanizëm.

15 bashki nga 34 kanë përfituar fonde përgjatë dy viteve, 16 të tjera kanë përfituar cdo vit ndërsa 2 bashki, Fushë Arrëz dhe Kurbin kanë përfituar vetëm gjatë një viti. Fondet më të mëdha kanë shkuar për bashkinë Tiranë me 14.25% të të gjithë Fondit të tre viteve bashkë pasuar nga bashkia Korçë me 11%. Më pas vijnë bashkitë Fier (8%), Durrës, Divjakë dhe Elbasan me nga 5% secila.





## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë



Në tabelën e mëposhtme paraqiten bashkitë e ndara sipas përkatësisë politike të kryetarit, në bashki të mazhorancës dhe të opozitës. Tabela përmban dhe përqindjen që secila bashki ka përfituar përgjatë tre viteve që vëzhgon ky raport në total.


BASHKITË E MAZHORANCËS		BASHKITË E OPOZITËS	
Bashkia Belsh	1.0%	Bashkia Berat	2.3%
Bashkia Dibër	1.7%	Bashkia Bulqizë	0.4%
Bashkia Divjakë	4.1%	Bashkia Cërrik	0.4%
Bashkia Durrës	5.1%	Bashkia Delvinë	0.4%
Bashkia Elbasan	5.0%	Bashkia Devoll	0.5%
Bashkia Fier	8.0%	Bashkia Dropull	1.0%
Bashkia Fushë Arrëz	0.3%	Bashkia Finiq	1.0%
Bashkia Gramsh	0.5%	Bashkia Gjirokastër	2.3%
Bashkia Has	0.8%	Bashkia Kamëz	0.0%
Bashkia Himarë	2.3%	Bashkia Kavajë	2.9%
Bashkia Këlcyrë	1.1%	Bashkia Klos	0.3%
Bashkia Kolonjë	0.7%	Bashkia Kuçovë	0.6%
Bashkia Korçë	11.0%	Bashkia Kukës	0.6%
Bashkia Krujë	1.6%	Bashkia Lezhë	0.1%
Bashkia Kurbin	0.4%	Bashkia Mallakastër	0.6%
Bashkia Libohovë	1.4%	Bashkia Mat	0.3%
Bashkia Librazhd	2.9%	Bashkia Peqin	0.4%
Bashkia Lushnje	2.3%	Bashkia Përmet	0.9%
Bashkia Malësi e Madhe	1.4%	Bashkia Pogradec	0.5%
Bashkia Maliq	1.2%	Bashkia Përrenjas	0.9%
Bashkia Memaliaj	0.3%	Bashkia Pustec	0.0%
Bashkia Mirditë	1.4%	Bashkia Rrogozhinë	1.1%
Bashkia Patos	1.0%	Bashkia Selenicë	0.1%



### Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Bashkia Poliçan	0.8%	Bashkia Shkodër	0.4%
Bashkia Pukë	0.4%	Bashkia Skrapar	0.8%
Bashkia Roskovec	1.6%	Bashkia Tropojë	0.4%
Bashkia Sarandë	2.3%	Bashkia Vau i Dejës	0.9%
Bashkia Shijak	0.5%	Bashkia Vorë	0.9%
Bashkia Tepelenë	0.6%	Bashkia Konispol	0.7%
Bashkia Tiranë	14.3%		
Bashkia Ura Vajgurore	0.4%		
Bashkia Vlorë	1.6%		
<b>TOTAL</b>	<b>79%</b>		<b>21%</b>

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve përgjatë 3 viteve ka financuar në total 286 projekte, prej të cilave 71 kanë shkuar për bashki të opozitës dhe 215 për bashki të tjera drejtuar nga përfaqësues të mazhorancës.



## IV. Shpërndarja e transfertës specifike

Sic e kemi shpejguar më sipër, transfertat specifike financojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin e funksioneve të reja të transferuara te njësitë e vetëqeverisjes vendore, për një periudhë tranzitore dhe për financimin e shërbimeve në raste të emergjencave apo situatave të ngjashme me interes kombëtar, ku kërkohet bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Pas reformës territoriale administrative, transfertat specifike janë përdorur për financimin e konvikteve të arsimit parauniversitar, qendrave të shërbimeve sociale, shërbimit të mbrojtjes nga zjarri, personelit mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar, rrugëve rurale, administrimit të pyjeve dhe ujitjes e kullimit.

### IV.1 Konviktet e arsimit parauniversitar



## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Në transfertën specifike të të treja viteve, bashkive ju janë akorduar fonde për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë përfshihen zëra si fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime.

Shpenzimet për personelin (paga dhe sigurime shoqërore) janë llogaritur mbështetur mbi numrin e punonjësve për secilin konvikt sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 502, datë 16.04.2008, “Për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1710, datë 29.12.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 502, datë 16.04.2008”, për punonjësit edukative (zëvendësdrejtor dhe edukator).

Ministria e Arsimit dhe Sportit para fillimit të vitit buxhetor duhet të dërgojë në njësitë e vetëqeverisjes vendore gjithë kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me pagat dhe sigurimet shoqërore për konviktet e arsimit parauniversitar. Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre konvikteve, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të mbështeten në kuadrin rregullator që ka përdorur Ministria e Arsimit dhe Sportit. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

Fondi ka qenë shumë më i madh gjatë vitit 2016 krahasuar me dy vitet pasardhëse, sic duket dhe në grafikun e mëposhtëm. Shifrat në grafik janë në mijë lekë. Gjatë të treja viteve nga kjo transfertë kanë përfituar 27 bashki, lidhur dhe me numrin e bashkive që kanë në territorin e tyre struktura të tilla si konviktet e arsimit parauniversitar.



### IV.2 Qëndrat e Shërbimeve Sociale

Në transfertën specifike për qendrat e shërbimeve sociale përfshihen fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit shërbyes dhe shpenzime operative për qendrat, “Lira”, Berat, “Balash”, Elbasan, “Shpresa” Shkodër dhe qendrat ditore të fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për Bashkinë Kuçovë dhe Kukës.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre qendrave mbështeten në kuadrin rregullator që përdor Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.



## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

Fondi është shpërndarë gati në mënyrë të barabartë përgjatë tre viteve me një rritje në 2018 dhe ka qenë në shifrat (në mijë lekë) 65 671 për 2016, 66 985 për 2017 dhe 87 835 për vitin 2018.

Nga kjo transfertë kanë përfituar gjatë periudhës në fjalë vetëm 5 bashki, Shkodër, Kukës, Kucovë, Berat dhe Elbasan.



### IV.3 Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH)

Në këtë transfertë specifike janë fondet për Policinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Ministria e Punëve të Brendshme duhet t'ju dërgojë bashkive të gjithë dokumentacionin që lidhet me personelin e këtij shërbimi, kuadrin ligjor dhe të dhëna të tjera që disponon të cilat janë të lidhura me shërbimin. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.


Grafiku i mëposhtëm tregon transfertën specifike për të tre vitet. Shifrat janë në mijë lekë. Si e shohim, kjo transfertë ka pësuar rritje progresive nga viti në vit.

Nga transferta për mbrojtjen nga zjarri gjatë vitit 2016 nuk kanë përfituar 8 bashki, gjatë vitit 2017 nuk kanë përfituar 22 bashki ndërsa gjatë vitit 2018 të gjitha bashkitë kanë përfituar fonde.



## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

### Mbrojtja nga zjarri



#### IV.4 Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar

Në këtë transfertë specifike janë fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Në fondet e personelit ndihmës të arsimit parauniversitar nuk përfshihet arsimi i mesëm profesional.


Ministria e Arsimit dhe Sportit, para fillimit të vitit buxhetor, duhet të dërgojë në bashkitë përkatëse kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me dosjet personale të punonjësve, pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor, personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

Fondet janë shpërndarë në dy kategori, arsimit parashkollor dhe arsimit parauniversitar. Në do të paraqesim totalin e këtyre dy kategorive. Kjo është transfertë më e madhe specifike krahasuar me funksionet e tjera. Shifrat janë në mijë lekë. Të gjitha bashkitë përfitojnë nga fondet e kësaj transferte.



## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

### Personeli arsimor




#### IV.5 Rrugët rurale

Në këtë transfertë specifike janë fondet për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Në këto fonde bëjnë pjesë fondet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në rrugët.

Fondet e transferuara mbeten në të njëjtat nivele përgjatë të tre viteve. Shifrat janë paraqitur në mijë lekë. Për rrugë rurale nuk kanë përfituar transfertë gjatë 2016, 2017 dhe 2018 në total 3 bashki, Kamza, Rrogozhina dhe Saranda.

### Rrugët rurale





#### IV.6 Administrimi i pyjeve

Në këtë transfertë specifike janë fondet për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Ministria e Mjedisit, para fillimit të vitit buxhetor 2017, duhet të dërgojë në bashkitë përkatëse kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me funksionimin e këtij shërbimi, si dhe për pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

Fondet për administrimin e pyjeve kanë pësuar një rritje të ndjeshme nga viti 2016 në 2018. Shifrat e mëposhtme janë në mijë lekë. Nga fondi për administrimin e pyjeve nuk kanë përfituar bashkitë Roskovec, Patos dhe Kamëz.



#### IV.7 Ujitja dhe Kullimi


Në këtë transfertë specifike janë fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, para fillimit të vitit buxhetor, duhet të dërgojë në bashkitë përkatëse kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me këtë shërbim.

Gjithashtu, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave duhet t'ju dërgojë bashkive të gjithë dokumentacionin që lidhet me personelin, mjetet, asetet dhe të dhëna të tjera që disponon, të cilat janë të lidhura me shërbimin. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.



## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Fondi për ujitjen dhe kullimin paraqitet në grafikun më poshtë dhe shifrat janë në mijë lekë. Ky fond ka qenë shumë i ulët në 2016. Gjatë 2017 ka pësuar një rritje të ndjeshme për tu ulur përsëri në 2017. Nga kjo transfertë përfitojnë të gjitha bashkitë.



## V. Përfundime

Skema konkurruese e granteve u prezantua në vitin 2006 si një mekanizëm për të rritur performancën dhe objektivitetin në financimin e investimeve të njësive vendore. Fondi gjithnjë e më i madh i Zhvillimit Rajonal ndan grantet e investimeve për bashkitë në baza konkurruese. Në të vërtetë, vitet e fundit, madhësia e Fondit për Zhvillim Rajonal është rritur ndjeshëm (shumë afër madhësisë së vetë grantit të pakushtëzuar), duke çuar në shqetësimin se po grumbullon fondet që duhet të ishin ndarë për grantin e pakushtëzuar. Përdorimi i gjerë i tij ka zvogëluar ndjeshëm autonominë fiskale lokale të bashkive dhe ka çuar në pretendime se ato janë ndarë për qëllime politike, të cilat nuk pasqyrojnë qëllime të qarta zhvillimore lokale.

Kësaj i shtohet dhe shqetësimi se fondet e FZHR mund të përdoren në mënyrë më efikase dhe efektive nga vetë bashkitë që kanë njohuri më të mira të nevojave reale dhe prioriteteve të zonave të tyre. Në fakt, grantet konkurruese – para FZHR së tanishme – u krijuan në mes të viteve 2000, dhe përbënin vetëm një pjesë të vogël të grantit të pakushtëzuar. Nga kjo perspektivë, Shoqata e Bashkive avokon për shfuqizimin e këtij Fondi dhe shpërndarjen e financimeve për bashkitë si pjesë e grantit të pakushtëzuar.

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve përgjatë 3 viteve ka financuar në total 286 projekte, prej të cilave 71 kanë shkuar për bashki të opozitës dhe 215 për bashki të tjera drejtuar nga përfaqësues të mazhorancës. Në total bashkitë e djathta kanë menaxhuar afërsisht 20% të Fondit e shpërndarë gati në mënyrë të barabartë në të tre vitet.

34 bashkitë e tjera të drejtuara nga mazhoranca menaxhuan pjesën tjetër të Fondit prej 80 % të shpërndarë në mënyrë gati të barabartë përgjatë tre viteve. Fondet më të mëdha kanë shkuar për bashkinë Tiranë me 14.25% të të gjithë Fondit të tre viteve bashkë pasuar nga bashkia Korçë me 11%.